



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.26/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private z. [REDACTED], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, z. Petrit Reçica, dhe përmbarueses private, [REDACTED], dhe pas seancës këshillimore, me datën 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-26/2021, datë 09.09.2021, Raporti i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, dt 06.09.2021, ankesa e palës ankuese [REDACTED] pronar i biznesit individual [REDACTED] nga Drenasi, dt 01.06.2021, si të pasafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 01.06.2021, përmes postës elektronike pala ankuese [REDACTED] pronar i biznesit individual [REDACTED] nga Drenasi ka paraqitur ankesë në Divizionin për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira (tash e tutje divizioni) ndaj përmbarueses private [REDACTED] si organ përmbarues e emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED]. Pala ankuese pretendon që përmbaruesja private ka zbatuar përmbarimin e lëndës P. nr 427/15 duke i bllokuar atij të gjitha mjetet financiare përfshirë edhe ato të cilat i ka pranuar si ndihmë nga shteti. Po ashtu, pala ankuese konteston shumën e mjeteve që kanë ardhur për përmbarim e që sipas tij nuk përputhen me faturat e lëshuara nga kreditori. Pas sigurimit të

informacioneve dhe shkresave, Divizioni ka përpiluar Raport me të cilin konstaton që përmbaruesja private [REDACTED] j ka vepruar në kundërshtim me nenin 21, 22 dhe 29 të LPP-së. Sipas raportit, përmbaruesja private mbi bazën e Propozimit të paraqitur nga ana e palës kreditore- [REDACTED] me dt 24.08.2015 ka nxjerrë urdhrin përmbarimor P. nr 427/2015 ndaj palës debitore- [REDACTED] përfaqësuar nga [REDACTED] me shumën prej 1103.20 euro. Ky urdhër, sipas parashtruesit, është lëshuar mbi bazën e faturave¹ të cilat nuk janë nënshkruar as nga kreditori e as nga ana e debitorit, ndërsa faturat janë lëshuar mbi bazën e një dokumenti të emërtuar si “marrëveshje për shërbim” dt 02.04.2007, e cila në pjesën për të dhënat e përgjithshme është përpiluar në formë elektronike kurse për pjesën tjetër ku janë përcaktuar kushtet e marrëveshjes janë të shkruara me shkrim dore. Parashtruesi thekson që kjo “marrëveshje për shërbime” nuk përbën dokument përmbarimor dhe nuk përmban titull ekzekutiv – *titulus executionis*, siç përcaktohet në nenin 21 të LPP-së sepse e njëjta konsiderohet marrëveshje interne dhe si e tillë nuk plotëson asnjërin nga titujt e përmbarueshmërisë nga neni 22 par 1, i LPP-së. Po ashtu, parashtruesi pretendon që faturat mbi bazën e së cilave është nxjerrë urdhri përmbarimor nuk përbëjnë dokumente të besueshme sepse nuk janë të nënshkruara as nga ana e palës kreditore dhe as nga ana e palës debitore, siç përcaktohet me nenin 29 par 1 nën par 1.3, të LPP-së.

Me datën 07.09.2021, Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ka paraqitur propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses private [REDACTED] / sepse e njëjta me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore ka vepruar në kundërshtim me nenet 21,22 dhe 29 të LPP-së duke propozuar Komisionit Disiplinor që në përputhje me nenin 373 të LPP-së të ndërmarr veprimet e nevojshme lidhur me këtë çështje.

Përmbaruesja private [REDACTED] në përgjigjen e saj me shkrim deklaroi se divizioni që ka zbatuar inspektimin ka tejkaluar kompetencat e tij ngase gjykatat kanë shqyrtuar ligjshmërinë e urdhrin përmbarimor. Prapësimi është refuzuar nga Gjykata Themelore me aktvendimin PPP. Nr 48/15 dt 04.03.2016 ndërsa ankesa ndaj këtij aktvendimi është hedhë poshtë me aktvendimin PPP. Nr 48/15 dt 08.11.2016. Sipas përmbarueses private, ndryshe nga gjykata që ka refuzuar prapësimin duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor, divizioni ka bërë vlerësimin e dokumentit përmbarimor apo përshtatshmërinë e atij dokumenti për përmbarim dhe si rezultat ka ardhur në një përfundim tjetër nga gjykata se organi përmbarues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përmbaruesja private thekson gjithashtu se sipas nenit 375 të LPP, procedura disiplinore mund të fillon brenda afatit prej gjashtë (6) muaj përkatësisht jo më vonë se një (1) vit nga shkelja e pretenduar disiplinore, e që në rastin konkret edhe po të kishte shkelje afati për fillimin e procedurës disiplinore ka skaduar.

Me datën 18.10.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, përfaqësuesi i Divizionit, z. Petrit Reçica dhe përmbaruesja private, [REDACTED].

¹ Faturat: 0154926 dt 01.09.2012; 0122052 dt 01.12.2011; 0125074 dt 21.12.2021; 0128454 dt 01.02.2012; 0133279 dt 01.03.2012 dhe 0147223 dt 01.07.2021.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarruesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesi i divisionit ka ngelur pranë raportit të paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e tij. Përmbarruesja private gjithashtu kanë paraqitur qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se propozimi për fillimin e procedurës disiplinore është i pasafatshëm.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që *“procedura disiplinore (ndaj përmbarruesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.”* Kjo do të thotë se procedura disiplinore më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, parashtruesi përkatësisht përfaqësuesi i divisionit në raport pretendon që përmbarruesja private ~~XXXXXXXXXX~~ ka vepruar në kundërshtim me nenin 21, 22 dhe 29 të LPP-së. Sipas raportit, përmbarruesia private mbi bazën e Propozimit të paraqitur nga ana e palës kreditore - ~~XXXXXXXXXX~~ me dt 24.08.2015 ka nxjerrë urdhrin përmbarrimor P. nr 427/2015 ndaj palës debitore- ~~XXXXXXXXXX~~ / e përfaqësuar nga ~~XXXXXXXXXX~~ me shumën prej 1103.20 euro. Ky urdhër, sipas parashtruesit, është lëshuar mbi bazën e faturave të cilat nuk janë nënshkruar as nga kreditori e as nga ana e debitorit, ndërsa faturat janë lëshuar mbi bazën e një dokumenti të emërtuar si “marrëveshje për shërbim” dt 02.04.2007, e cila në pjesën për të dhënat e përgjithshme është përpiluar në formë elektronike kurse për pjesën tjetër ku janë përcaktuar kushtet e marrëveshjes janë të shkruara me shkrim dore. Rrjedhimisht, shkelja e pretenduar i referohet urdhrin përmbarrimor P. nr 427/2015 dt 24.08.2015 dhe faturave të cilat janë lëshuar para kësaj date, dhe si të tilla, për këto pretendime për shkelje disiplinore nga ana e përmbarrueses private ka kaluar afati prej një (1) viti brenda të cilit mund të fillohet procedura disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMARRUESIT PRIVAT
DPL.nr 26/2021, datë 18.10.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUPI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

The following information is provided for your reference:
 The total number of items is 100.
 The total value is \$10,000.
 The average value per item is \$100.
 The standard deviation is \$20.
 The variance is \$400.
 The coefficient of variation is 0.2.
 The skewness is 0.1.
 The kurtosis is 0.05.
 The distribution is approximately normal.
 The data is as follows: